


МЕСТО ЗА
НАЛЕПНИЦУ



TESTI PROVUES I MATURËS
TESTI NGA LËNDA E NJOHURIVE TË PËRGJITHSHME MËSIMORE
GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

UDHËZIMI PËR PUNË

Lexoni me kujdes këtë udhëzim.

Mos e hapni testin dhe mos filloni me zgjidhjen e detyrave, deri sa këtë nuk e lejon arsimtari kujdestar.

Testi përmban 24 detyra, të cilat duhet zgjidhur për 180 minuta. Numri i pikëve për secilën detyrë është shënuar në test afër secilës detyrë. Numri maksimal i pikëve është 32.


Përgjigjet i shkruani me stilolaps në vendet e parapara për përgjigje. Keni kujdes se detyrat dallojnë sipas mënyrës në të cilën duhet të jepni përgjigje.

Shkruani pastër, duke pasur kujdes që përgjigjet tuaja të jenë të kuptueshme dhe në përputhje me rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Përgjigjet nuk duhet shkruar në tërësi me shkronja të mëdha. Nëse vëreni gabimin, atë që keni shkruar gabim shlyeni duke i rënë vizë dhe shënoni përgjigjen e re. Shënimet jo të lexueshme dhe përmirësimet e paqarta do të vlerësohen me zero (0) pikë.

Në detyrat me përgjigje të dhëna do të zgjedhni përgjigjen e saktë, duke ngjyrosur rrethin/rrathët përkatës. Nëse në këto detyra, krahas përgjigjeve të sakta keni ngjyrosur edhe ndonjë përgjigje të pasaktë, atëherë do të merrni zero (0) pikë.

Kenë besim te vetja dhe aftësitë tuaja. Ju dëshirojmë shumë suksese në punë!

Numri i faqeve në test:	16
Numri i faqeve të zbrazëta:	2

**Detyra 1.**

numri i pikëve: 1

Përcakto klasën e fjalëve të nënvizuara.

Mbi një kërcell që lëshoi tri gjetheza të gjelbra.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

<input type="radio"/>	ndajfolje,
<input type="radio"/>	lidhëz,
<input type="radio"/>	parafjalë,
<input type="radio"/>	pjesëz.

Detyra 2.

numri i pikëve: 1

Në fjalinë e dhënë, trego se në cilën fjalë bie theksi i fjalisë.

Ngjyros rrethin poshtë fjalës ku bie theksi i fjalisë.

Do të vij me ju në kinema.


Detyra 3.

numri i pikëve: 1

Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, gjej mënyrën e formimit të fjalës *jozyrtar*.

Jozyrtar është një fjalë e formuar me:

<input type="radio"/>	parashtesim
<input type="radio"/>	prapashtesim
<input type="radio"/>	prapashtesim dhe parashtesim

**Detyra 4.**

numri i pikëve: 1

Cila formë e shumësit të emrit *shkollë* është e gabuar?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

<input type="radio"/>	Shkollat tona
<input type="radio"/>	Shkollatë profesionale
<input type="radio"/>	Shkollat e fshatit

Detyra 5.

numri i pikëve: 1


Lexoni me vëmendje vargjet e dhëna.

*“Në mes tuaj kam qëndruar
e jam duke përvëlur,
që t’u ap pakëz dritë,
natën t’ua bënë ditë.”*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Autori i poezisë "Fjalët e qiririt", është:

<input type="radio"/>	Naim Frashëri
<input type="radio"/>	Asdreni
<input type="radio"/>	Ndre Mjeda
<input type="radio"/>	Sami Frashëri

**Detyra 6.**

numri i pikëve: 1

Lidh autorët me veprat përkatëse duke ngjyrosur rrethin përkatës.

	Kështjella	Lutjet e mbrëmjes	Malësorja	Nita
Nazmi Rrahmani	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ismail Kadare	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Josip Relja	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Anton Pashku	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Detyra 7.

numri i pikëve: 1

Lexoni vargjet me vëmendje.

LIRIA

*O shqipe, o zogjt' e maleve, kallzoni:
A shndrit rreze lirie nëto maja;
mbi bjesh' t'thepisuna e n'ograja,
ku del gurra e gjëmon përmallshëm kroni?*

*A keni ndie ndikund, kah fluturoni
ndër shkrepa, me ushtue kangën e saj?
A keni ndie një kangë të patravajë?*)
O shqipe, o zogjt' e maleve, kallzoni!*

*"Lirim, lirim!" — bërtet gjithkrah malsia.
A ka lirim ky dhë që na shkel kamba,
a veç t'mjerin e mblon anemban' robnia?
Flutro shqipe, flutro kah çelet lama,
sielliu maleve përreth që ka Shqipnia,
e vështroje ku i del liritit ama.*

Ndre Mjedja

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Poezia e përbërë prej 14 vargjesësh (dy strofa katërshe dhe dy treshe) quhet:

<input type="radio"/>	poemë
<input type="radio"/>	sonet
<input type="radio"/>	tregim

**Detyra 8.**

numri i pikëve: 1

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Autorët e Rilindjes Kombëtare, si: Naim Frashëri, Jeronim de Rada, Pashko Vasa, Ndre Mjeda i takojnë epokës letrare:

<input type="radio"/>	Realizmit
<input type="radio"/>	Romantizmit
<input type="radio"/>	Modernizmi
<input type="radio"/>	Letërsisë së vjetër

Detyra 9.

numri i pikëve: 2

Numëro pjesët e ndryshueshme të ligjëratës? Plotëso vendin bosh me vizë për të dhënë përgjigje të saktë.


Detyra 10.

numri i pikëve: 1

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Në fjalët: *zog- zok, breg- brek, murg-murk, djeg-djek*, shurdhimi i tingullit fundor nga **g** në **k** është i pranishëm në:

<input type="radio"/>	dialektin toskë
<input type="radio"/>	dialektin gegë
<input type="radio"/>	në të dy dialektet

**Detyra 11.**

numri i pikëve: 1

Cilat janë bashkëtingëlloret buzore?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

<input type="radio"/>	b, p, m
<input type="radio"/>	f,v,t
<input type="radio"/>	g, k, gj

Detyra 12.

numri i pikëve: 2

Trego trajtën, rasën, numrin dhe gjininë e grupit emëror të dhënë me fjalët me të zeza në shembullin e mëposhtëm.

*Ata bënë **disa veprime** të çuditshme.*


Plotëso vendin bosh me vizë për përgjigje të saktë.

Trajta _____

Rasa _____

Numri _____

Gjinia _____

**Detyra 13.**

numri i pikëve: 1

Punëtori punon deri në mesnatë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

i - ja e fjalës: *punëtor-i* për nga fjalëformimi është:

<input type="radio"/>	prapashtesë
<input type="radio"/>	mbaresë
<input type="radio"/>	nyja e prapme

Detyra 14.

numri i pikëve: 2


Duke plotësuar vendin bosh me vizë, ndani sipas përkatësisë (arkaizma, huazime dhe neologjizma) fjalët që vijojnë:

heshtë, sokak, aksham, jeniçer, topçi, përditësoj, dyrrotak, ikanak, gravatë, mëmëvrasje, hekur, shkronjë, asfalia

arkaizma: _____

huazime: _____

neologjizma: _____

**Detyra 15.**

numri i pikëve: 2

Në vijim keni poezinë Fjalët e qiririt të Naim Frashërit. Është vetëm strofa e parë për interpretim.

Fjalët e qiririt*I*

*Në mes tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëlur,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bënj ditë.*

.....

II

*Për ju do të rri të tretem,
Asnjë çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot.*


III

*Unë zjarrit nuk i druhem
Dhe kurrë s'dua të shuhem,
Po të digjem me dëshirë,
Sa të munt t'u ndrinj më mirë.*

Naim Frashëri

Plotëso vendin bosh me vizë për të dhënë përgjigje të saktë.

Interpretimi i strofës I

**Detyra 16.**

numri i pikëve: 1

Lexoni me vëmendje tekstin e dhënë.

Gjinia epike


Në gjininë epike futen ato vepra, në të cilat autori rrëfen ngjarje (vetë ose nëpërmjet personazheve). Këto vepra mund të jenë të shkruara: në vargje (epi, poema, cikle këngësh, epope që e marrin temën nga ngjarje historike etj.) dhe në prozë. Romani, novela, tregimi janë lloje të mëvonshme të prozës, të cilat e kanë zanafillën në veprat epike.

Në gjininë epike dallohen dhe llojet epiko-lirike, ku autori përveçse rrëfen ngjarjet, shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij. Të tilla mund të jenë : poemat, baladat (që e marrin temën nga jeta morale dhe shoqërore), fabulat (që nëpërmjet figurave të kafshëve trajtojnë marrëdhënie njerëzore). Në llojet epike rrëfimi bëhet përgjithësisht në vetën e tretë, por edhe në vetën e parë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Ky tekst i përket:

<input type="radio"/>	Teorisë së letërsisë
<input type="radio"/>	Historisë së letërsisë
<input type="radio"/>	Kritikës letrare

**Detyra 17.**

numri i pikëve: 1

Lexo me vëmendje strofën në vijim.


Poradeci

*Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir.
Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.
Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije,
Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Lloji i rimës së përdorur në këtë strofë është:

<input type="radio"/>	e puthur
<input type="radio"/>	e alternuar
<input type="radio"/>	e përmbyllur
<input type="radio"/>	varg i bardhë

**Detyra 18.**

numri i pikëve: 1

Poezia e mëposhtme është një tip i veçantë. Ka dy strofë me katër vargje dhe dy strofë me nga tri vargje. Lexoje me vëmendje.

LIRIJA

IV.

*Tý të kjosha falë, o dritë, âma e mbrodhsimit,
Ti dave terrin e egersis', e tine,
E lakmuemja e gjith dhënavet latine,
Ameriken e pshtove prei robnimit.*

*Porsi vegim u mbuze, e prei nalcimit
E puthe token me atò rreze, e shkrine
Akllin e vjeter qi kish mbet' e fshine
Vaj e pádije e anëmiq të lirimit.*

*E ndjeu toka njetë shënd e u gëzue si fëmija
Qi i qeshet lokes kúr ja reshë krahnorit;
E shpirt e zëmër neper buz'i shpraze.*


*Me nji te nyjeme mâ të bukur, pa tallaze
Shndriti deti njetë herë: prei katundorit
Nder fushë male mungulloi L i r i j a .*

Ndre Mjeda

Si quhet ky tip i vjershës?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

<input type="radio"/>	elegji
<input type="radio"/>	sonet
<input type="radio"/>	idil
<input type="radio"/>	epitaf

**Detyra 19.**

numri i pikëve: 2

Në bazë të të dhënave që janë dhënë më poshtë, ndërto një tekst dhe trego për çfarë bëhet fjalë.

- * 36 shkronja
- * Alfabet i njësuar
- * Alfabeti shqip me bazë alfabetin latin
- * Kongresi i Manastirit, Nëntor
- * Gjergj Fishta 1908 kryetar i Kongresit

Plotëso vendin bosh me vizë për të dhënë përgjigje të saktë.

Në kuadër të formimit të shtetit shqiptar, lindi nevoja e _____

Detyra 20.

numri i pikëve: 2

Në fjalitë e mëposhtme dallo foljen kalimtare dhe jokalmimtare.

Plotëso vendin bosh me vizë për tu përgjigjur saktësisht nëse folja (fjala me të zezë) është kalimtare ose jokalmimtare

Unë shkova pranë tij -	<u>jokalmimtare</u>
Thërras me forcë -	_____
Shkova dorën në flokë -	_____
Thërras shoqen time -	_____
Fjeta gjatë -	_____
E fjeta mendjen -	_____
Kaloj klasën -	_____
Humba në mendime -	_____
Humba rrugën -	_____
Kaloj rrugës -	_____

**Detyra 21.**

numri i pikëve: 1

Në fjalinë e dhënë, gjeni se me çfarë kallëzuesi është ndërtuar fjalia:

Ai ishte regjisor i një filmi historik.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

<input type="radio"/>	kallëzues emëror
<input type="radio"/>	kallëzues i thjeshtë foljor
<input type="radio"/>	kallëzues i përbërë foljor

Detyra 22.

numri i pikëve: 1

Lasgush Poradeci


YLLI

Del nga zemëra një yll
 Nuku di nga vjen i shkreti:
 Sikur djeg përdhe mi pyll,
 Sikur shkon për-së-përpjeti
 Sikur digjet përsëri
 Mun në fund në kraharuar
 Sikur sbret nga qjell' i ri,
 Yll i jetës së pashuar.
 Yll e mall që shëmbëllen
 Drejt prej zemrës së qetë,
 Vjen e ndrin e shkon nga vjen:
 Rrëzë qjelli, rrëzë jete.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Procesi i frymëzimit artistik njëjtësohet me lindjen e një ylli. Poeti gjen vija paralele mes këtyre dy dukurive, sepse:

<input type="radio"/>	frymëzimi artistik është dukuri sa abstrakte, aq edhe e qenësishme;
<input type="radio"/>	poeti kërkon t'ia konkretizojë atë lexuesit, përmes një perceptimi konceptual dhe vizual;
<input type="radio"/>	frymëzimi krijues ka të njëjtat veti si ylli, i cili ka funksion të ndriçojë, të ngrohë e ushqejë shpirtërisht zemrën me anë ndjesive dhe emocioneve që shpreh;
<input type="radio"/>	frymëzimi e bën krijuesin të përjetojë emocionalisht momentin, jetën;
<input type="radio"/>	të gjitha së bashku.

**Detyra 23.**

numri i pikëve: 2

Nëse gjykimi është i saktë, ngjyros rrethin në kolonën PO, kurse nëse gjykimi është i paskaktë ngjyros rrethin në kolonën JO.

Gjykimi	PO	JO
Epika sugjeron dhe evokon ndjenja dhe emocione.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Poezia epike shkruhet në monokolonë.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Poezia epike e merr lëndën e vet nga historia.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Heronjtë epikë janë heronj që luftojnë për interesat personale.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Poema epike ka elementin fantastik.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Detyra 24.

numri i pikëve: 2

Lexo me vëmendje tekstin në vijim.

Nuk kisha dëshirë të shkoja në asnjë zyrë. Isha i lodhur duke ndenjur në kolltuk para shokut Zylo. Veç kësaj, më pihej një kafe...Duke ndenjur i menduar fillova të qesh me vete: " Për mua shoku Zylo është fenomenal...Si do të me shkojë puna me të, vallë?! Tek rrija në tavolinë, pash nga dritarja Bakirin, një nga kolegët e mi të ardhshëm. Ai më vuri re dhe u kthye..."

Dritëro Agolli- " Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo "


Plotëso vendin bosh me vizë për të treguar:

Rrëfimtarin: _____

Vetën e rrëfimit: _____

A është i njëjtë rrëfimtari me autorin? Pse? _____

FAQE E ZBRAZËT



FAQE E ZBRAZËT

